



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.10.2021, ora 10:30

**Drejton mbledhjen:**

**Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Prezantimi i projektligjit “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”. (*Komision për dhënie mendimi*).

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Europiane dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut – Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2020” (*Komision për dhënie mendimi*).

3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat” (*Komision për dhënie mendimi*).

4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës për Bashkëprodhimin Kinematografik (e rishikuar) Rotterdam, datë 30.01.2017” (*Komision për dhënie mendimi*).

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Fatmir Xhafaj, Ermonela Valikaj (Felaj), Saimir Hasalla, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Bardhyl Kollçaku, Lavdërim Krrashi, Oerd Bylykbashi, Gazment Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Dhurata Tyli (Çupi), Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Elda Hoti, Jurgis Çyrbja dhe Erisa Xhixho.

**Mungojnë:**

Bledjon Nallbati, Damian Gjikhuri, Gerta Duraku, Toni Gogu dhe Gledis Çeliku.

**Të ftuar:**

Bledar Çuçi – Ministër i Brendshëm

Elena Pici – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme

Muhamet Rrumbullaku – Drejtor i Përgjithshëm i SHÇBA-së

Fatmir Shehu – Drejtor Juridik i Ministrisë së Brendshme

Armand Skapi – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme

Anis Lamllari – Këshilltare e Ministres për Europën dhe Punët e Jashtme

Vasilika Vjero – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Doriana Toro – Përgjegjëse e Sektorit të Tatimeve Direkte të Drejtorisë së Harmonizimit Fiskal në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Entela Çipa – Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës

Eduart Makri – Drejtor i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë

## HAPET MBLEDHJA

**Klotilda Bushka** – Përsëritje, të nderuar kolegë dhe të ftuar!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të datës 21.10.2021 me rendin e ditës, si vijon.

Si pikë të parë kemi prezantimin e projektligjit “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.

Si pikë të dytë kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Europiane dhe Komisionit European, për programin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut – Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2020”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi. Relator është zoti Klevis Xhoxhi.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi. Relator do të jetë përsëri kolegu Klevis Xhoxhi.

Si pikë të katërt kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës për Bashkëprodhimin Kinematografik (e rishikuar) Roterdam, datë 30.01.2017”, për të cilin jemi përsëri komision për dhënie mendimi. Relatore do të jetë zonja Ermonela Felaj.

Besoj se jemi të gjithë dakord me rendin e ditës, i dakordësuar edhe nga kryesia, kështu që vijojmë me pikat e rendit të ditës.

Në lidhje me projektligjin “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, për prezantimit të tij kemi prezentë ministrin e Brendshëm, zotin Bledar Çuçi, të cilit i uroj mirëseardhjen në komision, i cili shoqërohet nga zonja Elena Pici, sekretar i Përgjithshëm, zoti Muhamet Rrumbullaku, drejtor i Përgjithshëm i SHÇBA-së, dhe zoti Fatmir Shehu, drejtor Juridik i ministrisë.

Fjala për ju, zoti Çuçi.

**Bledar Çuçi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Në radhë të parë, i uroj komisionit punë të mbarë, meqenëse është edhe hera e parë që jam në Komisionin e Ligjeve!

Në lidhje me projektligjin “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, në fakt, ky ligj vjen dhe është pjesë përbërëse e paketës tërësore ligjore për të reformuar strukturat e sigurisë, edhe

në përmbushje të prioritetit të qeverisë për të rritur parametrat e sigurisë për forcimin e luftës ndaj krimit në tërësi dhe krimit të organizuar në veçanti, si dhe luftës kundër korrupsionit.

Aktualisht Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave vepron në bazë të ligjit nr. 70 të vitit 2014, por gjatë kësaj periudhe ka pasur një sërë ndryshimesh ligjore, kushtetuese, strukturore që e kanë bërë të domosdoshëm rishikimin e këtij ligji të tilla, si: reforma në drejtësi; përgjegjësia e realizimit të vetingut ndaj subjekteve; rikonceptimi me standarde i statusit të punonjësit dhe i të gjithë shërbimit; hapja e rrugës për investime në fushën e teknologjisë, ndryshimi i ligjit të Policisë Gjyqësore; krijimi i institucioneve të reja të akuzës, si SPAK-u dhe BKH-ja; rikonceptimi i trajtimit të doktrinës “Nevojë për njohje”, që materializohet në funksionet që punojnë me informacionin e klasifikuar, dhe deri te forcimi i integritetit të shërbimit për të plotësuar siç duhet misionin mbikëqyrës ndaj subjekteve të kësaj. Këta objektiva të zhvillimit institucional afatmesëm janë të përmendur edhe në dokumentet strategjike, siç është Strategjia e SHÇBA-së 2020-2024.

Një tjetër element shumë i rëndësishëm, që kërkoi një reformim dhe një ligj të ri për shërbimin, janë edhe rekomandimet e partnerëve tanë ndërkombëtarë në fushën e rendit dhe të sigurisë, kryesisht është me rëndësi për t’u përmendur rekomandimi për t’u përputhur me standardet e EPAC-ut, që, siç e dini, është *European Partnership Against Corruption*.

Ky projektligj në tërësinë e tij ka 13 krerë dhe 89 nene, është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me ICITAP-in dhe, gjithashtu, ka kaluar një proces të gjerë konsultimi publik, ku kanë qenë të pranishme institucionet e përfshira dhe subjektet mbikëqyrëse, por edhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.

Çfarë synon kryesisht ky projektligj? Në radhë të parë, reformimin e shërbimit apo të agjencisë, siç do të quhet pasi të miratohet ky ligj, si një agjenci inteligjente për të luftuar korrupsionin dhe për të parandaluar veprimtarinë e paligjshme në radhët e subjekteve të Agjencisë, duke e përafuar atë me agjenci të tjera homologe të vendeve anëtare të Bashkimit Europian; transformimin e shërbimit apo të agjencisë drejt një modeli më demokratik dhe institucional, si pjesë e komunitetit të agjencive ligjzbatuese dhe inteligjente në vend sipas standardeve të EPAC-ut, si në aspektin e misionit, ashtu edhe në drejtim të përcaktimit të detyrave funksionale, përgjegjësi, strukturës dhe personelit; forcimin e funksionimit të shërbimit apo agjencisë në zbatim të parimeve të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut; rritjen e kapaciteteve të shërbimit apo agjencisë për një qasje proaktive ndaj fenomeneve korruptive të subjekteve të shërbimit; parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe hetimin paraprak të veprimtarisë kriminale e korruptive në subjektet e shërbimit dhe përmirësimin e

infrastrukturës teknologjike të shërbimit për t'iu përgjigjur dinamikës dhe kërkesave gjithnjë në rritje.

Tani dua të ndalem kryesisht te risitë që ka ky projektligj, krahasuar me legjislacionin ekzistues.

Në radhë të parë, është zgjeruar fusha e përgjegjësisë. Pra, tashmë asaj që sot quhet SHÇBA, por që ne pas miratimit të ligjit do ta quajmë agjenci, në fushën e përgjegjësisë do t'i shtohen edhe subjekte të tjera, siç është Garda e Republikës apo Shërbimi Zjarrfikës, përveç Policisë së Shtetit që është deri tani.

Gjithashtu, edhe ndryshimi i emrit ka kuptimin e vet. Doktrina e mbikëqyrjes, sipas koncepteve dhe standardeve të EPAC-ut, kërkon reformimin e Shërbimit edhe në emërtimin e tij, duke u dhënë garanci qytetarëve se ka një strukturë të specializuar që mbikëqyr me metoda të ligjshme organizatën më të madhe të sigurisë, siç është Policia e Shtetit. Pra, qytetari do të dijë ku të drejtojë ankesat apo pretendimet e tij në drejtim të përmbushjes së misionit policor, në respekt të ligjit dhe Kushtetutës së vendit.

Një risi tjetër është kalimi në një strukturë civile, pra zhveshja nga gradat dhe krijimi i kësaj strukture civile me një zhvillim të qartë karriere dhe duke shmangur konfliktin e interesit me subjektet që mbikëqyrin. Ne gjucojmë që kalimi i personelit në strukturë civile, duke ruajtur kapacitetet njerëzore aktuale dhe ato që do rekrutohen në të ardhmen, e bën strukturën më të qëndrueshme, më të hapur, më transparente dhe më civile, në mendësi dhe veprimtari, në konceptin e mbikëqyrjes së jashtme civile. Gjithashtu, unifikon të gjithë punonjësit në të drejta dhe detyrime, gjë të cilën në aktin e legjislacionit aktual nuk e gjen një rregullim të tillë, pasi disa nga të drejtat dhe përfitimet suplementare i gëzojnë vetëm punonjësit me gradë. Përgjatë gjithë frymës së projektligjit kemi synuar pikërisht të unifikojmë këto të drejta dhe benefite, që do të ketë tashmë kjo strukturë civile në të ardhmen me subjektet që ajo mbikëqyr.

Një risi tjetër është që ky legjislacion, ky projektligj, përcakton detyrimet që rrjedhin nga akte ligjore si të miratuara, ndërkohë si ai për vlerësimin kalimtar dhe periodik të subjekteve mbikëqyrëse. Pikërisht në ligjin përkatës për "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe SHÇBA- së", kjo strukturë ka marrë funksione të reja, të cilat duhet të përfshihen në ligjin organik të kësaj agjencie.

Risi tjetër është veprimtaria verifikuese për pajisjen me Certifikata të Sigurimit të Personelit të subjekteve. Ky detyrim ka lindur edhe pas miratimit në vitin 2015 të vendimit të qeverisë "Për miratimin e rregullave të sigurimit të personelit", i cili i jep të drejtën shërbimit apo agjencisë në të ardhmen, si autoritet verifikues, e pajisjes me certifikatë sigurie të subjekteve, që për shkak të detyrës duhet të njihen me informacion të klasifikuar. Aktualisht

veprimtaria e pajisjes me certifikatë ndiqet edhe nga Policia e Shtetit dhe nga SHÇBA, agjencia. Në të parën bëhet aplikimi, plotësimi i formularëve dhe përcjellja për verifikim në agjenci apo SHÇBA.

Ndjekja e këtij procesi në këtë mënyrë ka ndikuar në krijimin e hapësirave abuzuese, ku nuk respektohet doktrina e “nevojës për njohje” në funksionet që punohet me informacionin e klasifikuar. Gjithashtu, nga inspektimet e bëra deri tani nga SHÇBA-ja në Policinë e Shtetit, ajo ka evidentuar një sërë problemesh, të cilat kërkojnë detyrimisht përfshirjen e sektorit të certifikimit që është në Policinë e Shtetit në një strukturë të posaçme për trajtimin e kësaj përgjegjësie, pikërisht në agjenci apo në SHÇBA-në e sotme apo agjencinë në të ardhmen. Konkretisht, disa nga problematikat që janë edhe shqetësuese po i rendis si më poshtë, pra që lidhen me procesin e pajisjes me certifikatë dhe janë evidentuar tashmë nga SHÇBA-ja:

Në radhë të parë, nuk bëhet ndjekja në mënyrë permanente e pajisjes me certifikatë të punonjësve bazuar në nivelin e klasifikimit dhe detyrës apo funksionit organik që mbajnë.

Së dyti, nuk ndiqen afatet e pajisjes me certifikatë dhe krijohen periudha të pambuluara, ndërkohë që punonjësi vazhdon të punojë me informacionin e klasifikuar.

Së treti, në emërimet apo transferimet e punonjësve nuk është marrë në konsideratë niveli me certifikatë që ka punonjësi, duke e evidentuar faktin se funksioni organik duhet të jetë në harmoni me nivelin e certifikatës së sigurisë për t’u njohur me informacionin e klasifikuar.

Së katërti, ka pasur raste që edhe pse u janë pezulluar apo refuzuar pajisja me certifikatë punonjësve nga DSIK-ja, këta punonjës kanë vazhduar të njihen me informacionin e klasifikuar.

Problematika e fundit, subjektet e agjencisë aktualisht, nuk kanë krijuar një database për të kontrolluar e mbikëqyrur punonjësit që nuk janë të pajisur me certifikatë apo u mbaron afati e duhet të riaplikojnë. Duke mos pasur përgjegjësi dhe autoritet të drejtpërdrejtë në procesin e aplikimit, si dhe në mbikëqyrjen e këtij procesi, ka rezultuar që aplikimi të jetë spontan dhe në dëshirën apo ndërgjegjen e gjithsecilit. Pra, është kjo mënyrë e të funksionuarit të procesit që ka krijuar efekte të drejtpërdrejta në implikimin e punonjësve të policisë në veprimtari korruptive, pasi duke mos u mbikëqyrur procesi, në mënyrë të vazhdueshme dhe institucionale, kanë ndodhur raste të shmangies apo të aplikimit me vonesë nga ana e tyre, ndërkohë që këta punonjës kanë vazhduar të njihen me informacion të klasifikuar pa u pajisur me CSP.

Pra, i përmenda këto problematika që ka nxjerrë vetë SHÇBA-ja për të treguar sa i rëndësishëm është ndryshimi në ligj dhe që është një risi që e sjell pikërisht ligji që kemi sjellë, për ta ndryshuar mënyrën dhe procedurën e aplikimit për certifikatën.

Sipas projektit të ri, tashmë agjencia apo SHÇBA-ja sot, merr përgjegjësinë për subjektet e saj që të udhëheqë procesin që nga faza fillestare e aplikimit deri në përfundimin e plotë të praktikës, duke kryer veprimtarinë verifikuese dhe dërguar për kompetencë DSIK-së me konkluzionin nëse ekziston ose jo kushti i sigurisë. Kujdes, se nuk bëhet fjalë për marrjen e atributit të vendimmarrjes për pajisjen me certifikatë, sepse atë e ka DSIK-ja, por është i gjithë procesi që çon deri në marrjen e certifikatës, që do të udhëhiqet tashmë nga agjencia dhe do të shkëpusë hallka të procesit nga policia.

Risia e pestë lidhet me procesin e ekzaminimit poligrafik. Ekzaminimi poligrafik ka lindur si detyrim në ligjin 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" dhe është parashikuar si një nga fazat e rekrutimi të personelit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Deri tani është bërë me disa rregulla dhe për nga infrastruktura është ndihmuar fuqimisht nga ambasada e Shteteve të Bashkuara dhe ICITAP-i, ku janë trajnuar 5 ekspertë, por lind nevoja që ky proces kaq i rëndësishëm dhe me sensitivitet kushtetues për sa i takon pjesës së të drejtave të njeriut të bëhet i normuar me norma shumë të qarta ligjore. Sigurisht, mbetet një proces mjaft i rëndësishëm në funksion të kontrollit të figurës, i cili do të aplikohet në rekrutimin e punonjësve të Agjencisë në të ardhmen, si dhe për rekrutimin e subjekteve që mbikëqyrë Agjencia, me qëllim garantimin e integritetit të tyre gjatë ushtrimit të detyrës.

E reja e gjashtë që sjell ky projektligj ka të bëjë me të drejtën e hetimit disiplinor, atribut ky që me këtë projektligj do t'i jepet Agjencisë apo SHÇBA-së sot. Sipas rekomandimeve të ekspertëve të programit të ICITAP-it, si dhe standardeve të EPAC-ut, strukturat që mbikëqyr Agjencia janë në konflikt të hapur interesi nëse ankesat apo shkeljet që konstatohen nga Agjencia do të hetoheshin nga vetë strukturat ku janë me detyrë subjektet.

Nisur nga treguesit e deritanishëm që disponon SHÇBA-ja, të siguruara gjatë inspektimeve të zhvilluara, si dhe raportet e vlerësimit të jashtëm të përgatitur nga ekspertet e programit ICITAP apo dhe vlerësimit të mekanizmit të ankesave të zhvilluar nga misioni PAMECA V, rezulton se numri i punonjësve të niveleve menaxheriale të ndëshkuar me masë disiplinore për shkelje të rënda disiplinore të kryera nga ana e tyre apo performancë të dobët të strukturave që ata menaxhojnë është ekstremisht i ulët, edhe për shkak të këtij konflikti interesi që përmenda më sipër.

Objekt i hetimit disiplinor të Agjencisë do të jenë të gjitha shkeljet e rënda, të cilat konstatohen nga vetë Agjencia gjatë veprimtarisë së saj mbikëqyrëse. Në këtë projektligj përcaktohet se kategoritë e shkeljeve, si dhe llojet e masave disiplinore, që përcaktohen në aktet ligjore e nënligjore të subjekteve përkatëse, dhe apelimi i masave disiplinore të bëhet pranë Komisionit të Apelimit. Pra, krijohet edhe një komision për t'i dhënë të drejtën e apelimit çdo subjekti që do të marrë një masë disiplinore drejtpërdrejt nga Agjencia apo SHÇBA-ja sot.

Edhe sipas ICITAP-it, marrja e kësaj kompetence është roli minimal që duhet të luajë Agjencia, pavarësisht se prapë kjo nuk është në përputhje të plotë me parimet e EPAC-ut, por duke kuptuar që është një hap shumë i madh përpara, në krahasim me mungesën e llogaridhënies, deri tani ne e kemi lënë në këtë nivel.

Kjo nevojë del më e evidente në rastet e incidenteve të rënda, të cilat krijojnë impakt të drejtpërdrejtë në komunitet. Për këtë duhet të ketë një hetim të pavarur dhe publiku nuk do të pranojë që kjo të bëhet nga subjektet që mund të kenë shkaktuar pikërisht këto incidente, pasi kemi dukshëm konfliktin real të interesit apo të perceptuar.

Nëse Agjencia zbulon shkelje administrative apo nevojën për të bërë ndryshime politikash, ajo duhet të ketë kompetencë për t'i vënë ato në zbatim. Publiku nuk do të besojë subjektet e Agjencisë që të hetojnë apo vënë në zbatim ndryshimet.

E gjithë kjo bëhet për të rritur besimin e publikut dhe jo për të ndëshkuar subjektet.

Të nderuar kolegë,

Mbikëqyrja është më shumë sesa thjesht vëzhgim dhe raportim. Ka, gjithashtu, një komponent mbikëqyrjeje për të siguruar që gjërat bëhen në mënyrë korrekte sipas Kushtetutës dhe ligjit, gjithmonë në interes të publikut.

Ne kemi bindjen se ky është një produkt ligjor cilësor në funksion të rritjes së sigurisë dhe luftës kundër korrupsionit, një produkt ligjor që do t'i rezistojë kohës, do të shërbejë për ndërtimin e institucioneve më të mira, që kanë besueshmëri më të lartë të publikut dhe për rrjedhojë të një shoqërie më të mirë.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, Ministër Çuçi, për prezantimin e nismës!

Të nderuar kolegë, siç edhe jeni njoftuar, kjo pikë e rendit të ditës është vetëm për prezantim nga ana e ministrit në lidhje me këtë projektligj.

Ndërkohë, ju informoj se projektligji është depozituar në legjislaturën e kaluar, por nuk është arritur dot të shqyrtohet deri në përfundim të legjislaturës së kaluar dhe prandaj hyn si i ridepozituar për herë të parë në këtë legjislaturë. Ligji është paraqitur që në shkurt të vitit të



kaluar dhe draftligji është i njëjtë me atë që është paraqitur, por gjatë kësaj kohe partnerët tanë ndërkombëtarë që kanë punuar me Ministrinë e Brendshme, ICITAP-i, pra, misioni pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kanë paraqitur disa komente, të cilat, me sugjerimet e relatores, kur të kemi diskutimin në parim dhe nen për nen së bashku, do të përfshihen në një tekst integral që do t'ju vihet paraprakisht në dispozicion, në mënyrë që të keni kohën e mjaftueshme për ta studiuar.

Prandaj, për t'u lënë kohë kolegëve të grupit të punës, por edhe relatores që të kenë mundësi të punojnë, si dhe kolegëve të opozitës dhe maxhorancës që të njihen me tekstin, do ta lëmë në një seancë tjetër diskutimin dhe miratimin në parim dhe nen për nen. Uroj që zoti Çuçi të gjejë kohën për të qenë përsëri i pranishëm në atë seancë, sepse besoj që kolegët do të kenë pyetje dhe diskutime në lidhje me draftin.

Fjalën e ka zonja Ermonela Felaj, meqenëse është relatore dhe pastaj zoti Alibeaj.

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

I nderuar zoti Ministër,

Më lejoni të ndërhyj për të bërë një sqarim të vogël procedural. Siç e tha edhe kryetarja, projektligji është paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë në muajin shkurt. Komisionet parlamentare të caktuara për ta shqyrtuar këtë projektligj kanë qenë dhe vijojnë të jenë Komisioni Parlamentar i Sigurisë Kombëtare, i cili është komision përgjegjës për këtë projektligj dhe Komisionin i Ligjeve.

Nga shkurti deri mars, përpara zgjedhjeve, ajo që ka ndodhur (po e sqaroj meqenëse në legjislaturën e kaluar mbaja detyrën e kryetares së Komisionit të Sigurisë Kombëtare), është që projektligji u prezantua në Komisionin e Ligjeve dhe u miratua në parim. Ndërkohë që në Komisionin e Sigurisë nuk vazhdoi më tej puna, por vetëm iu kërkua mendim disa strukturave, si: Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtorisë për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar. Për shkak të zgjedhjeve veprimtaria e Kuvendit u reduktua, u ndërpre, kështu që ata komente që ne kërkuam nga këto institucione kanë ardhur, kanë ardhur komentet edhe nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, për të cilat, së fundi, bëj me dije se janë parë të gjitha, edhe nga ICITAP-i, që është kontributori kryesor në nënshkrimin e këtij projekti ligjor, ku një pjesë e tyre janë reflektuar në tekstin e ligjit. Kështu që, gjykoj se do të ishte më e përshtatshme, për punën e të gjithëve, që ne të punojmë në një tekst, i cili ka reflektuar shqetësimet e ndërmarra.

Nga ana tjetër, ishte po kaq e arsyeshme, e falënderoj edhe kryetaren që veproi në këtë mënyrë për rendin e ditës, së bashku besoj se patëm edhe një komunikim me zotin Bylykbashi,

që ne të kishim vetëm një prezantim, ku mund të shprehemi dhe të diskutojmë mbi një tekst të reflektuar. Pavarësisht se prezantimi i ligjit ishte bërë një herë në këtë komision, nuk do të ishte normale që (meqenëse përbërja dhe legjislatura është e re) të mos kishim një prezantim rishtazi të projektligjit.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** - Faleminderit, zonja Felaj, për sqarimin!

Zoti Alibeaj, fjala për ju.

**Enkelejd Alibeaj** - Zonja kryetare, ju falënderoj!

Në këtë linjë ishte edhe kërkesa që unë do të bëj.

Së pari, me shumë të drejtë zonja Felaj tha se ka një set dokumentesh të ardhura nga të gjithë partnerët ndërkombëtarë, të cilët në fokusin e veprimtarisë së tyre kanë çështjet e rendit dhe të sigurisë. E mira do të ishte, pa dyshuar në besnikërinë e reflektimit të atyre vërejtjeve në tekstin tuaj, që ne të kishim dokumentet...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord, nëse i ka marrë ai, jemi dakord, mjafton që t'i kemi.

Kërkesa e dytë që kam është që, e mira është që jo vetëm për etikë, por edhe rregull që duhet krijuar në parlament, ministri të jetë edhe në seancat e tjera, sepse besoj se është një nga ligjet më të rëndësishme për një ministër të Brendshëm, ku ka interesin e vet. Por, unë do të kërkoja që, përveç ministrit, të jetë prezent edhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Ky ligj ka dy aktorë kryesorë, pjesën ekzekutive, ministrin në këtë rast, i cili ka të drejtën e vet për të kontrolluar performancën e policisë, por sigurisht që ka të drejtë edhe i kontrolluari, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, të shprehë brenda parlamentit, edhe pse mund t'i ketë dhënë me shkresë, të gjitha sensibilitetet lidhur me këtë projektligj, qoftë edhe për faktin se tashmë ka ndodhur një fakt, është i emëruar rishtazi si drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, do të ishte në nderin, por edhe në dobinë e këtij komisioni, edhe të komisionit tjetër që të ishte prezent.

Ju faleminderit!

**Klotilda Bushka** - Po, zoti Xhafaj.

**Fatmir Xhafaj** - Ju faleminderit, kryetare!

Edhe unë bashkohem me mendimin e kolegëve, që ky është një ligj shumë i rëndësishëm dhe duhet të marrë të gjithë vëmendjen e duhur nga ne, por, pa dyshim, vëmendjen kryesore duhet ta marrë nga Komisioni i Sigurisë, i cili është komisioni përgjegjës, nëse nuk gabohem, ne jemi komision për dhënie mendimi. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që ne të bëjmë

një shqyrtim të përciptas, por duhet ta shikojmë në pozicionin që neve na ka caktuar Rregullorja për t'u shprehur për projektet.

Unë sugjeroj që (duke parë kohën e gjatë në të cilën është paraqitur ligji, duke e parë edhe nga një vështrim i kujdesshëm që jam përpjekur të bëj, që ligji ka nevojë për përmirësime) është më mirë të shikohet një agjendë e përbashkët me Komisionin e Sigurisë, që t'i ulim në një tryezë të gjithë aktorët dhe t'i dëgjojmë, se sa t'i marrim këtu si në raport. Do të ishte një gjë pozitive në qoftë se subjektet e këtij ligji, drejtori i Policisë, Garda e Republikës, SHÇBA-ja, ministria, por edhe aktorët e tjerë, institucione dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, në të cilat pikëtakohen shumë me këtë ligj, të ulen në një tryezë të përbashkët, me pjesëmarrjen e relatorëve ose përfaqësuesve të palëve nga Komisioni i Ligjeve dhe nga Komisioni i Sigurisë. Besoj se kjo do ta bënte më produktive tryezën dhe të mos ishte thjesht një seancë ku ata thjesht na dëgjojnë ne, por të jenë më interaktive me çfarë ne kemi, sipas qëndrimeve përkatëse.

Besoj se ka disa aspekte, siç është çështja e vlerësimit kalimtar, siç u tha. Prandaj, duhet të ulemi me kujdes, sepse janë disa gjëra që janë të kaluara në kohë. Mendoj se duhet të lëmë një seancë tjetër pas këtij procesi.

**Klotilda Bushka** - Fjalën e ka zoti Qefalia dhe më pas zoti Bylykbashi.

**Xhemal Qefalia** – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, edhe unë u bashkëngjitem parafolësve dhe jam dakord që ky ligj kërkon vëmendjen maksimale. Unë dhe kolegu Alibeaj jemi edhe anëtarë të Komisionit të Ligjeve, edhe të Komisionit të Sigurisë dhe na bën mirë që po njihemi me këtë. Unë dua të them se ky ligj këtë konsiston: ndan policinë, zjarrfikësit, komandën e Gardës e të tjerë. Në qoftë se ne do të ftonim policinë, i bie që të ftonim edhe komandantin e Gardës, edhe komandantin e Zjarrfikësve. Kjo nuk na e heq të drejtën ne, meqenëse drejtori i Policisë qenka emëruar i ri, si komision ta thërrasim në seancë dëgjimore dhe ta dëgjojmë, por kjo nuk ka lidhje me ligjin për të qenë prezent drejtori i Policisë së Shtetit.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** - Fjalën e ka zoti Bylykbashi. Pastaj do ta mbyll diskutimin, sepse po flasim për një procedurë pune, të cilën ne e vendosim.

Zoti Bylykbashi e ka fjalën, më pas zoti Mediu. Pastaj duhet ta mbyll këtë pikë të rendit të ditës, që të kalojmë te pika tjetër.

**Oerd Bylykbashi** – Zonja kryetare, unë gjykoj që propozimi për të punuar së bashku me Komisionin e Sigurisë është propozim me vend dhe na e jep mundësinë që ne të sinergjizojmë punën dhe të ekonomizojmë të gjithë përpjekjen për këtë ligj, që është vërtet shumë i rëndësishëm dhe, siç u propozua, të vijmë të gjithë institucionet që janë të përfshira.

Unë nuk e di nëse ka kontribute edhe nga PAMECA ose edhe nga OSBE-ja që ka departament të veçantë, nuk ka deri tani.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, mund t'i bëhet një kërkesë, në qoftë se ata kanë një kontribut. Në të shkuarën është ndjekur si praktikë nga Komisioni i Ligjeve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Megenëse ligji është i rëndësishëm, dua të kërkoj edhe një herë që të kishim edhe relator nga ana jonë në këtë punë të përbashkët.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

Zoti Mediu, fjala për ju.

**Fatmir Mediu** – Unë i dëgjova me vëmendje kolegët, por mendoj se duhet të jenë pak më të përcaktuara detyrat që kanë dhe përgjegjësitë që kanë, sidomos Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes. Nuk duhet të ngatërrojmë politikëbërjen me anën operacionale. Është shumë e rëndësishme që ne si komision të arrijmë në përfundimin që për sa i përket politikëbërjes është qeveria, janë parlamenti dhe ministria përkatëse. Ata marrin dhe i konsultojnë mendimet me gjithë të pjesën civile, policore apo Ministrinë e Mbrojtjes, ushtarake. Në qoftë se ne kemi përgjegjësi për sa i përket politikëbërjes, raporti ynë është me ministrinë. Informacionet te ne duhet t'i përcjellë ministria, edhe debatet, diskutimet rreth ligjit, si me ne, edhe me partnerët, përndryshe do të krijojmë një situatë të papranueshme, ku do të kemi struktura policore që bëjnë politikë, ministria të bëjë operacionet, struktura e mbrojtjes, ministria të bëjë anën operacionale dhe ana ushtarake të bëjë politikëbërjen. Ky miksim dhe ndarja e përgjegjësisë është një problem jashtëzakonisht i madh në këto struktura. Duhet të ndajmë rolin civil, politikëbërjen nga roli operacional, ushtarak apo policor.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Mediu!

Në fakt, në përfundim të të gjitha diskutimet të kolegëve në lidhje me vijimin e punës për shqyrtimin e këtij projektligji, ndaj të njëjtin mendim me zotin Mediu. Ne, tashmë, kemi një praktikë të konsoliduar pune që për çdo projektligj krijojmë grupe teknike pune dhe nismëtarët që në rastin konkret janë ministria, sigurisht, në ato grupe teknike bëjnë zgjedhjen e tyre të sjellin cilët janë përfaqësuesit. Ne kemi kërkuar në grupe teknike pune të vijmë pa diskutim edhe përfaqësues të institucioneve, të cilat normohen në veprimtarinë e tyre nga projektligji që sillet. Sigurisht që pjesën e konsultimit me institucionet e tjera, siç është në rastin konkret me Drejtorinë e Policisë dhe me Gardën, të gjitha komisionet, në vijim të punës së tyre paraprake, para se ligji të vijë dhe të diskutohet në komisione, e realizojnë nëpërmjet

këmbimeve me shkrim. Institucionet mund t'i kenë dhënë mendimet e tyre me shkrim për projektligjin para se nisma të depozitohet në Kuvend, ose mund të kenë komente që i sjellin gjatë konsultimit. Kështu që procesi është tashmë i normuar, është një proces që është një praktikë e mirë pune në Kuvend që ndodh, por, sigurisht, në diskutimet që bëhen në këtë komision apo në komisionet e tjera të Kuvendit përfaqësuesi i nismëtarit është përfaqësues politik. Nëse ne duam të dëgjojmë, të marrim mendime nga institucione të ndryshme, tej atyre që janë sjellë, pa diskutim që kemi mekanizmin e konsultimit dhe në punën teknike, siç me të drejtë zonja Felaj tha, do të punohet për t'i reflektuar me të gjithë kolegët që janë të interesuar këtu komentet e institucioneve të tjera, duke përfshirë edhe Policinë e Shtetit, sigurisht që mund të jenë të pranishëm në grupe teknike pune. Por në seancën e shqyrtimit në komision marrëdhënia është parlament-qeveri dhe qeveria do të përfaqësohet nga zoti Çuçi. Nëse zoti Çuçi mendon të jetë i shoqëruar jo vetëm nga stafi i ministrisë, por edhe nga përfaqësues të tjerë të organeve, me të cilat ka ndërveprim apo ka fushë përgjegjësie për të qenë të pranishëm në këtë komision, është zgjedhje e tij. Kështu që, gjithsesi, unë do të komunikoj me zotën Bylykbashi dhe me relatoren e çështjes për metodologjinë e punës, sepse po ju them që të gjitha kërkesat tuaja do të ezaurohen dhe do të realizohen.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Më falni, sepse nuk janë kërkesa procedurale që i hodhëm në votim. Kjo është një çështje që ka të bëjë me komunikim ndërmjet nesh. Të lutem, po ju jap të drejtë, nuk është se po jua hedh poshtë kërkesën.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Thjesht po ju them kemi një praktikë pune dhe kemi një procedurë të Rregullores.

Konsultimin, siç dëgjuat nga zonja Felaj, në komisionin përgjegjës, që është Komisioni i Sigurisë, është bërë me institucionet. Le ta replikojmë gjatë shqyrtimit teknik që do të bëjmë para se të vijë çështja në komision, sepse janë ndërruar drejtuesit, ka kaluar kohë, të shikojmë se si janë qëndrimet, në referim edhe të komenteve që kanë ardhur nga partnerët, të cilët kanë punuar ngushtësisht me këtë ligj. Sigurisht, pas kësaj pune do të kemi një draft të integruar në dispozicion të të gjithëve, me kohën në dispozicion për të qenë gati për diskutimet në parim dhe pa diskutim që do ta vendosim së bashku se si do të veprojmë në atë moment. Për ta shqyrtuar së bashku me Komisionin e Sigurisë, në kuadrin e takimeve teknike të punës, mendoj se është një gjë e realizueshme dhe ne mund ta bëjmë. Por për shqyrtim me kalendar të përbashkët të të dyja komisioneve mendoj se nuk ka kuptim, sepse ne jemi komision për dhënie mendimi dhe do të marrim të gjithë kohën për të mbaruar punë tonë pa diskutim. Sigurisht,

grupet e punës së përbashkët teknike me deputetë nga të dyja anët të Komisionit të Ligjeve dhe të Komisionit të Sigurisë le të jenë së bashku dhe le të punojnë për këtë çështje.

Për sa i takon çështjes së relatorit, patjetër, zoti Bylykbashi, por nuk e vendosim sot, e diskutojmë në kuadër të këshillimit në vijim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon,)*

Po përsërisim të njëjtat gjëra.

Një fjali, zoti Alibeaj.

**Enkelejd Alibeaj** – Zonja kryetare, ne këtu fjalën kemi dhe fjala nuk harxhohet, mund të flasim edhe dy herë, edhe tri herë.

Na the se propozimet tona janë të mira qoftë për konsultimin gjerë e gjatë që është bërë paraprakisht. Po, dakord, shumë mirë që krijohet një klimë dhe edukatë konsultimi, por kjo nuk do të thotë që ai konsultim, i bërë jashtë kësaj salle, jo në sytë e medias, të mos replikohet këtu. Ne jemi të gatshëm edhe për njohuritë tona, për të gjithë arsyet e mira që ju i thatë, pra është ndërprerë në legjislaturën e kaluar, rifillohet prapë, kanë ndodhur fakte, ngjarje të reja, aktorë të rinj, pse jo të mos kenë të drejtën të jenë prezentë. Nuk është e vërtetë që marrëdhënia është vetëm Kuvend-qeveri, marrëdhënia është Kuvend-qeveri po e po dhe drejtues të lartë të administratës, një prej të cilëve është edhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë apo edhe dy drejtorët e tjerë, po e plotësoj kërkesën e zotit Qefalia; edhe dy drejtorët e tjerë të Gardës dhe i zjarrfikëseve të kenë të drejtën të vijnë e t'i japin sensibilitetet e tyre këtu, jo si një kërkesë për të krijuar tensione me ministrin. Po ua them që tani unë: jo. Roli dhe pozicionet politike dhe administrative janë të përcaktuara, nuk janë këtu, janë aty. Është e qartë kjo dhe nuk kemi asnjë lloj diskutimi. Arsyeja pse duhet t'i dëgjojmë është që në këtë projektligj deri tani ka standarde delikate, për të cilat ne duhet që ne të jemi në maksimumin e komoditetit për të vendosur, duke pranuar dialektikën mes përndjekësit, që është ministri, dhe të përndjekurit, që është policia, ose edhe Garda. Këtë duhet ta pranojmë

Edhe kërkesën tjetër që ne bëmë, zoti Xhafaj bëri, është mirë që ta pranojmë. Në një mbledhje të përbashkët, gjithmonë në frymën e një konsultimi, që me të drejtë ju e lavdëruat pak më parë, konsultimi nuk duhet të jetë para dhe jashtë kësaj salle, duhet të jetë para, jashtë, por edhe brenda dhe gjatë procedurës së miratimit të projektligjit.

Është e thjeshtë, ekonomizon kohën, i jep mundësi publikut të njihet dhe zërave të mbytur, që nuk u është dëgjuar zëri, të mund të shprehin mendimin e tyre.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

Po themi të gjithë të njëjtat gjëra dhe po biem të gjithë dakord.

Po ju informoj se të gjitha institucionet që ju kërkoni të thirren e kanë dhënë me shkrim mendimin e tyre. Mendimin nuk e jep titullari, e jep institucioni, nuk ka rëndësi se kush është titullari sot ose kush do të jetë nesër. Të gjitha këto mendime do të jenë pjesë e akteve që do t'u vihen në dispozicion të gjithëve paraprakisht gjatë shqyrtimit dhe gjatë debatit.

Tani për modalitetet e veprimtarisë së punës në lidhje me këtë projektligj, e thashë edhe një herë, do të veprojme sipas praktikës më të mirë të Kuvendit dhe unë do të këshillohem me zotin Bylykbashi dhe me relatoren e çështjes, zonjën Felaj, sa i takon Komisionit të Ligjeve, si dhe me zotin Naço, kryetarin e Komisionit të Sigurisë për vijimin e punës.

Faleminderit, zoti Çuçi!

Jeni i lirë të shkoni. Jeni i mirëpritur në mbledhjen tjetër!

**Sekretar**

**Klevis Xhoxhi**

**Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve**

**Euzheni Pengili**

**Sekretare e komisionit**

**Vijola Sinaj**



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.10.2021, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Europiane dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkuftar IPA II, Maqedoni e Veriut – Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2020” (*Komision për dhënie mendimi*).

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Fatmir Xhafaj, Ermonela Valikaj (Felaj), Saimir Hasalla, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Arben Pëllumbi, Bardhyl Kollçaku, Lavdërim Krrashi, Oerd Bylykbashi, Gazment Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Dhurata Tyli (Çupi), Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Elda Hoti, Jurgis Çyrbja dhe Erisa Xhixho.

#### **Mungojnë:**

Bledion Nallbati, Damian Gjikhuri, Gerta Duraku, Toni Gogu dhe Gledis Çeliku.

#### **Të ftuar:**

Armand Skapi – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme

Anis Lamllari – Këshilltare e Ministres për Europën dhe Punët e Jashtme



**Klotilda Bushka** – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Europiane dhe Komisionit Europian për programin e bashkëpunimit kufitar IPA II, Maqedoni e Veriut - Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2020”.

Ju lutem, të ftuarit të zënë vendet!

Të ftuarit janë: zoti Armand Skapi, sekretar i Përgjithshëm, dhe zonja Arlis Lamllari, këshilltare e ministres për Europën dhe Punët e Jashtme. Relator do të jetë deputeti Klevis Xhoxhi.

Në mbledhjen tjetër, kur ministria juaj do të jetë prezantuese e nismave, do të kërkojmë prezencën e një përfaqësuesi të nivelit politik. Nuk mund të vijnë nismat dhe të përfaqësohen ministrinë vetëm nga përfaqësuesit administrativë dhe teknikë.

Gjithsesi, kemi një rregull, ua kemi komunikuar ministrive: Kuvendi u ka kërkuar ministrive të kenë një përfaqësi të tillë, kështu që të kihet në konsideratë për herën tjetër.

Fjala për ju për të na bërë një prezantim të projektligjit.

**Armand Skapi** – Faleminderit!

E nderuara kryetare,

Të nderuar anëtarë,

Qëllimi i këtij projektligji është të ratifikojë marrëveshjen e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Komisionit Evropian, për “Programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut-Shqipëri, 2014-2020, alokimet për vitin 2020”. Marrëveshja e financimit është miratuar në parim nga ana e Këshillit të Ministrave nëpërmjet vendimit. nr. 318, datë 02.06.2021, “Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet dhe Komisionit Europian për “Programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut – Shqipëri, 2014-2020, alokimet e vitit 2020”.

Kjo marrëveshje financimi u nënshkrua për palën shqiptare nga Koordinatori Kombëtar i Fondeve IPA në Shqipëri, njëkohësisht Kryenegociator datë 25.06.2021 dhe nga ana e Koordinatorit Kombëtar të Fondeve IPA në Maqedoninë e Veriut, datë 09.12.2020.

Alokimet e vitit 2020 për këtë program financohen nga një grant i BE-së nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej 1,530,000 eurosh për të dyja vendet, pa përfshirë bashkëfinancimin kombëtar të dy shteteve .

Nënvizojmë se në total kontributi që BE-ja jep për zbatimin e përbashkët të programit Maqedoni e Veriut-Shqipëri për periudhën 2014-2020 arrin vlerën e 11 milionë 900 mijë eurove. Të gjitha alokimet për këtë program kanë qenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve financiare midis vendit tonë, Maqedonisë së Veriut dhe Komisionit Europian. Kjo është marrëveshja e fundit financiare që nënshkruhet për këtë program, për periudhën IPA II 2014-2020.

Sjell në vëmendje se gjashtë marrëveshje të tjera financimi janë konkluduar mes këtyre palëve për të njëjtin program (për alokimet e viteve 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 dhe alokimet e vitit 2019), të cilat janë ratifikuar tashmë nga Kuvendi. Përfitues të këtij programi janë zonat: në Maqedoni rajoni i Pelagonias, rajoni i Pologut, rajoni Jugperëndimor; në Shqipëri qarku i Dibrës, qarku i Elbasanit, qarku i Korçës.

Programi i bashkëpunimit Maqedoni e Veriut -Shqipëri ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin midis dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Ky program mbështet gjithashtu shkëmbimin e eksperiencës dhe njohurive midis përfituesve, si dhe përmirësimin e politikave publike mes autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e programit.

Duke marrë parasysh aspektet problematike që ndikojnë në ekonominë e zonës dhe zhvillimin e saj të qëndrueshëm, programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme tematike: te nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore; te rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve; te mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje financiare do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve në të ardhmen midis Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, sipas prioriteteve të përcaktuara në program, duke u mundësuar në këtë mënyrë aktorëve rajonalë dhe vendorë nga të dyja vendet të shkëmbejnë jo vetëm njohuritë dhe përvojat, por edhe të prodhojnë rezultate të dukshme dhe një efekt të matshëm për sektorin socio-ekonomik.

Aktualisht ky program, që ka filluar në vitin 2014, ka shpallur tri thirrje.

Thirrja e parë për projektpropozimet u hap më 16 shtator 2016 dhe qëndroi e hapur deri më 1 nëntor 2016. Kjo thirrje u hap për tri prioritetet e programit me një buxhet total prej 2 milionë e 890 mijë eurosh, kontribut i BE-së, alokime të viteve 2014-2015. Nga kjo thirrje janë financuar tashmë 9 projekte, me një buxhet të përgjithshëm prej 2 milionë e 982 mijë e 48 eurosh, përfshirë bashkëfinancimin e partnerëve.

Kontratat e financimit përfunduan periudhën e nënshkrimit në janar të 2018-ës. Të gjitha projektet e kësaj faze, pra 9 projekte, tashmë janë realizuar.

Thirrja e dytë për projektpropozimet u hap më 27 nëntor 2018, e cila qëndroi e hapur deri më 1 shkurt 2019. Kjo thirrje u hap për dy prioritetet e programit: inkurajimi i turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore dhe mbrojtja e mjedisit, promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimaterike, si dhe parandalimi i menaxhimit të riskut. Buxheti i përgjithshëm për këtë thirrje ishte 2 milionë e 890 mijë euro, kontribut i BE-së, kjo përfshinte edhe alokimet e viteve 2016-2017. Procesi i vlerësimit përfundoi në korrik të vitit 2019 nga delegacioni i BE-së në Shkup, ku rezultuan si të suksesshme 5 projekte me një vlerë totale financimi për të dyja vendet prej 2,8 milionë eurosh.

Zbatimi i tyre ka nisur në fund të vitit 2019 dhe aktualisht vetëm një prej tyre ka përfunduar zbatimin e tij.

Thirrja e tretë dhe e fundit për këtë program u hap më 11 tetor 2020 dhe qëndroi e hapur deri më 15 shkurt 2021. Kjo thirrje u hap për të tria prioritetet e programit, me një buxhet total prej 4 milionë e 930 mijë eurosh, pra, siç shihet për thirrjen e tretë ka një dyfishim të vlerës së përlllogaritur me dy thirrjet e para. Ky është kontributi i BE-së dhe mbulon alokimet për periudhën 2018-2019-2020. Kjo thirrje është ende në fazën e vlerësimit të projekteve nga autoriteti kontraktues, i cili është delegacioni i BE-së në Shkup, Maqedonia e Veriut.

Menjëherë pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje i hapet rrugë kontraktimit të projekteve të thirrjes së parë.

Në lidhje me evidentimin e problematikave, ashtu si në çdo program tjetër të bashkëpunimit ndërkufitar, problematika kryesore pas miratimit të kësaj marrëveshjeje do të lidhet kryesisht me mundësitë e kapaciteteve përfituese të subjekteve shqiptare për përthithjen dhe zbatimin me sukses të projekteve të financuara nga ky program.

Në vazhdim puna e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, por edhe kryenegociatorit dhe koordinatorit ndërkombëtar për fondet IPA, do të fokusohet në mbështetjen e përfaqësuesve shqiptarë për hartimin dhe zbatimin me sukses të projekteve, duke marrë masat e nevojshme organizative dhe trajnuese.

Ju faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Skafi!

Zoti Xhoxhi, fjala për ju në cilësinë e relatorit.

Ju lutem, fokusoheni te çështje për të cilat ky komision ka edhe kompetencën e vet, pra përputhshmërinë me Kushtetutën dhe kuadrin ligjor. Kini parasysht që jemi komision për dhënie mendimi, nuk jemi komision përgjegjës.

**Klevis Xhoxhi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Mirëdita kolegë!

Ky projektligj është në përputhje me nenet 81, pikat 1, dhe 100 të Kushtetutës, me ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me ligjin nr. 37/2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër nëpërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Komisionit Europian “Për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën para anëtarësimit IPA II””. Pas miratimit të projektvendimit nga ana e Këshillit të Ministrave marrëveshja i nënshtrohet ratifikimit me ligj nga ana e Kuvendit bazuar në nenin 121, pika 1, të Kushtetutës.

Ky projektligj parashikon ratifikimin nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të marrëveshjes së financimit, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Europiane, dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut-Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2020.

Nuk dua të zgjatem dhe të përsëris fjalët që sapa u lexuan në relacion.

Në përfundim rezulton se projektligji nga ana ligjore është në përputhje me Kushtetutën dhe nga ana procedurale ka respektuar dispozitat e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Në këto kushte u propozoj kolegëve ta miratojmë.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Ka diskutime nga kolegët?

Zonja Tyli dhe zoti Mediu.

**Dhurata Tyli** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, përfaqësuesve të ministrisë!

Së pari, një falënderim për të gjitha kontributet e Komisionit Europian për vendin tonë!

Në relacionin që shoqëron projektligjin në një nga paragrafët, por edhe ju e cituat, thuhet se i gjithë kontributi vetëm për këtë projekt 2014-2020 është 11 milionë e 900 mijë euro, nga të cilat janë implementuar 6 projekte dhe ky ishte i fundit, nëse e kuptova qartë, ku përfitues në Shqipëri janë: qarku i Dibrës, qarku i Elbasanit dhe rajoni i Korçës.

Kontributet do të jenë: nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore, rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve; mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimaterike, si dhe parandalimi i menaxhimit të riskut. Këto janë tri prioritetet ku do të implementohet ky projekt. A mund të më citoni, ju lutem, se çfarë ka përfituar qarku i Dibrës, meqenëse unë përfaqësoj këtë qark? Çfarë ka përfituar nga ky projekt qarku i Dibrës në këta 6 vjet, të paktën sa i përket turizmit, konkurrencës, investimeve e të

tjera, sepse ky qark vazhdon të jetë qarku më i varfër? Sa organizata kanë përfituar nga ky projekt?

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Tyli!

Fjala për zotin Mediu.

**Fatmir Mediu** – Unë kam një sugjerim nisur edhe nga përvoja kur kam qenë në Ministrinë e Mjedisit. Ne përfshijmë shumë projekte në financime të vogla, ku impaktet nuk janë të dukshme. Ministria e Jashtme mendoj se nuk duhet të jetë vetëm pritëse e propozimeve, por të bëhet edhe një analizë e këtyre projekteve dhe impakteve që kanë pasur deri tani. Ndoshta mund të kemi më pak projekte, por impakte më të mëdha, me financime të qenësishme.

Projektet ndërkufitare kanë një vlerë në menaxhimet e përbashkëta të marrëdhënieve. Ndoshta një nga projektet që duhet ta shikoni me një rëndësi prioritare është menaxhimi i përbashkët i liqenit të Ohrit, parë edhe në kuadër të përfshirjes së mbrojtjes që i është bërë nga UNESCO-ja.

Pra, ne flasim për shumë projekte, të cilat copëzohen dhe impaktin e kanë fare minimal, prandaj unë sugjeroj se duhen më pak projekte, më konkrete dhe me impakt më të madh.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, Zoti Mediu!

Zonja Felaj e ka fjalën.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja kryetare!

Kam vetëm një diskutim për të bërë, nuk kam pyetje. Unë dua që nëpërmjet kësaj mbledhjeje të komisionit të promovoj faktin që ratifikimi i marrëveshjeve të financimit, si kjo që jemi duke diskutuar sot, që bëhen nëpërmjet fondeve IPA, është diçka, të cilën duhet ta promovojmë më shumë sesa në një komision parlamentar. Në fakt, më vjen mirë që marrëveshje të tilla janë duke u parë realisht më shumë sesa një komision parlamentar, sepse nuk ka qenë kështu më parë në Kuvendin e Shqipërisë, marrëveshjet nuk kalonin në komisionet e tjera parlamentare përveç se në Komisionin e Ligjeve.

Ne duhet ta bëjmë këtë, sepse aktorët lokalë, e para, duhet të kenë dijeni për të tilla projekte mbi vlerat e financimit që ofron Bashkimi Europian dhe vlerën e financimit që detyrohet të japë shteti shqiptar, si dhe të kenë parasysh që e gjitha është kompetitive. Pra, garohet ndërmjet aktorëve lokalë të kësaj ane të kufirit dhe të anës tjetër të kufirit.

Në momentin që qarqet, bashkitë, organizata të ndryshme joqeveritare në këto territore nuk janë të nxitura për ta bërë këtë gjë, kuptohet që dhe mundësia për të përfituar nga të tilla projekte pothuajse zerohet. E mira është që ne si deputetë, edhe si të zgjedhur, t'u japim zë

këtyre projekteve dhe ta ndjekim këtë çështje. Në mos gaboj, nuk është se vendos, me zotin Skapi kemi diskutuar edhe më parë, shteti shqiptar se kush fiton në këto projekte, por e vendos aktor tjetër.

Shqipëria patjetër duhet të nxisë kapacitetet që ka dhe të rrisë informacionin me qëllim që të bëhen përfitues.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Felaj!

Zoti Alibeaj.

**Enkelejd Alibeaj** – Faleminderit!

Jam shumë dakord me atë që tha zonja Felaj, që duhet t'u japim një zë. Po ashtu, është diçka shumë e mirë që diskutohen nëpër disa komisione, ky është diskutuar edhe në Komisionin e Sigurisë, por që t'u japim një zë është mirë që disa rregulla minimale t'i respektojmë me thënë të drejtën.

Në diskutimin që u bë në Komisionin e Sigurisë, ishim bashkë me zotin Qefalia, kishim nivel më të lartë të përfaqësimit, nuk kam asnjë gjë me zonjën dhe zotërinë që janë të pranishëm, ishte e pranishme zëvendësministrja, ndërsa sot ka zbritur në rangun e sekretarit të Përgjithshëm. Kjo do të thotë që ministrja e Jashtme nuk besoj të jetë më e rëndësishme dhe të ketë më shumë punë sesa ministri i Brendshëm, i cili 5 minuta më parë ishte këtu. Kjo është mënyra se si i jepet zë, gjëja e parë, dhe respektohet edhe parlamenti.

Së dyti, është e vërtetë që, për t'i dhënë zë duhen rritur kapacitetet, këtu kam një pyetje, për ata që po lexojnë, në fakt. Si ka shkuar në projektet e mëparshme performanca juaj për rritjen e kapaciteteve për thithjen e këtyre financimeve? Pyetja e parë.

Pyetja e dytë, të cilën e bëra edhe në mbledhjen e Komisionit të Sigurisë, për të cilën nuk mora dot një përgjigje, sepse dy përfaqësuesit e ministrisë, zëvendësministrja dhe një zotëri tjetër, nuk e mbaj mend se kush ishte dhe çfarë roli kishte, premtuan që do të sillnin informacion, nuk e di nëse e kanë sjellë, por meqë ju jeni të pranishëm ndoshta jua kanë dhënë juve atë informacion. U pretendua që janë 9 projekte të tilla, nëse nuk gaboj, që janë implementuar më parë. Kam një pyetje të thjeshtë: sa në këto projekte janë fituese në pozicionin e liderit, sepse me sa mbaj mend përfituesi do të ishte në rolin e liderit, sa prej tyre dhe cilët janë subjekte shqiptare?

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Zoti Bylykbashki, e ka kërkuar fjalën.

Zoti Skapi, më pas do të jetë radha juaj për t'u kthyer përgjigje kolegëve.

**Oerd Bylykbashi** – Faleminderit!

Në vijim edhe të asaj që u tha më herët këtu nga kolegët, në lidhje me kapacitetet ekzistuese apo ato që duhen zhvilluar për të përthithur apo për të qenë të suksesshëm në përfitimin e këtyre fondeve nëpërmjet projekteve, cili është instrumenti që i mban të informuar në mënyrë të vazhdueshme të gjithë ata që janë të interesuar për të ndërhyrë më pas për t'i paraqitur?

Po, është e vërtetë që nuk i përcaktojmë ne fituesit, por cili është instrumenti, sepse dihet që janë këto në mënyrë të vazhdueshme? Aktorët e interesuar dinë t'u drejtohen jo thjesht duke e ditur që është një marrëveshje e miratuar dhe ekziston diku një garë që do të hapet. Çfarë instrumentesh kemi që aktorët e interesuar shqiptarë të aplikojnë dhe më pas të jenë edhe të suksesshëm në fitimin si lider në këto projekte, si ky që do miratojmë sot nëpërmjet kësaj marrëveshjeje?

Në fund të relacionit shoh që është e papërcaktuar vlera e përfitimit, por mendohet që mund të jetë 900 mijë euro. Pra, dua të kuptoj nëse kjo vlerë 900 mijë euro është në raport me atë që financon, jemi ne pjesa mazhoritare në këtë?

**Klotilda Bushka** – Faleminderit kolegë, për pyetjet tuaja!

Në fakt, edhe unë u bashkohem kolegëve për çka i intereson më shumë Shqipërisë në këto lloj programesh siç është rritja e kapaciteteve lokale për të përthithur sa më shumë nga fondet, të cilat janë në dispozicion.

Mendoj, sepse nga raportet që kemi parë kur kemi qenë në këtë komision nga legjislatura e kaluar, nga viti në vit kishim një rritje, se kemi vend për përmirësim dhe ajo që është më e rëndësishmja ndërgjegjësimi në nivel lokal deri në qelizat bazë të pushtetit lokal është shumë i rëndësishëm, sepse jo në të gjithë Shqipërinë kapacitetet janë njësoj. Në momentin kur negociohen ndoshta nuk është vetëm Ministria e Jashtme organi kompetent përgjegjës në lidhje me këto, por të bëhet një rakordim me të gjitha institucionet përgjegjëse kur negociohet në mënyrë, që pjesa e rritjes së kapaciteteve dhe e ndërgjegjësimit të marrë një fokus që ne të thithim në fund nga fondet që na japin edhe më shumë sesa kemi thithur deri më sot.

Fjalën e ka zoti Skapi, për t'iu përgjigjur pyetjeve që kanë bërë kolegët.

Më pas do të kalojmë në votim.

Faleminderit!

**Armand Skapi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, të nderuar deputetë për pyetjet që bëtë!

Siç u tha më lart, ky është një program, i cili ka filluar që në vitin 2014, pas një marrëveshjeje të lidhur ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Europian, e ratifikuar në vitin 2015.

Fondet në lidhje me këtë program dhe për thirrjet me të cilat miratohen edhe marrëveshjet individuale vjetore ndërmjet vendeve përfituese dhe Komisionit Europian ndahen në bazë të projekteve fituese. Projektet fituese bëhen mbi bazë konkurrence, pra nuk bëhen se paracaktohet që do të bëhen projekte për 3 fushat, por vetë subjektet, të cilat me të dyja anët e kufirit, nuk është se përcaktohet një institucion shqiptar shtetëror apo OJF, por duhet që ky të jetë në partneritet të ngushtë me një partner të krahut tjetër të kufirit.

Për të ardhur te pyetja konkrete, meqë janë përfitues 3 rajone kufitare, siç janë qarku i Dibrës, qarku i Elbasanit dhe qarku i Korçës, në thirrjen e parë të këtij programi qarku i Dibrës ka fituar 3 projekte, të cilat mund t'i citoj: “Standarde bujqësore dhe certifikime, ndërtimi i kapaciteteve për përthithjen e financimit dhe strategjitë e marketingut në mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe tregtisë”.

Te projekti i dytë “Përtej kufijve” kanë qenë aplikues CBS-ja, Created Business Solution Tiranë, Agjencia e Zhvillimit Rajonal Tirana, RDA2, dhe Zona e Veprimit të Qarkut të Dibrës.

Projekti i dytë është “Përtej kufijve”, prezantimi i turizmit të zgjuar dhe ndarjes së ekonomisë (biologët e Shqipërisë janë subjekti përfitues, Bashkia Mat).

Projekti i tretë është “Ndërmarrjet sociale, ura midis sektorit privat dhe biznesit tradicional”. Qendra Aritra Vizion Peshkopi është subjekti përfitues nga pala shqiptare.

Në lidhje me thirrjen e dytë, siç thamë, janë 5 projekte përfituese.

*(Ka ndërhyrje nga salla.)*

**Klotilda Bushka** – Ju lutem, kolegë, mos ta ndërpresim zotin Skapi!

Jeni deputetë dhe mund të kërkonit informacion nga bashkitë, ku ju vetë jeni përfaqësues, për realizimin e këtyre projekteve, sepse, në lidhje çështjen e rendit të ditës, zoti Skapi mund t’ju japë informacion se si në kuadër të kësaj marrëveshjeje janë dhënë projekte, ndërsa se si janë realizuar mekanizmat e kontrollit, janë të tjera gjëra.

**Armand Skapi** – Ne mund të japim të gjithë informacionin e nevojshëm për secilin nga projektet, sa na takon ne si ministri, për monitorimin e tyre.

**Klotilda Bushka** – Për të vijuar kërkesën e zonjës Dhurata, unë do t’ju lutesha që informacionin, që ju kërkojnë në lidhje me qarqe të caktuara, sepse përfaqësojnë zona të Shqipërisë, ta sillni me shkrim brenda një afati të arsyeshëm dhe mos të na vononi për sa kohë është bërë një kërkesë në Komisionin e Ligjeve.



**Armand Skapi** – Kam vetëm një saktësim, që 11 milionë e 900 mijë euro janë për tërë programin nga viti 2014 deri në vitin 2020, jo se janë për një projekt.

Gjithsesi, për thirrjen e dytë projekti me përfitues Qarkun e Dibrës është “Çiklizmi ndërkufitar, një tjetër nivel turizmi i aventurës Mavrovë - Rostush - Dibër”. Përfitues është Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale dhe Këshilli i Qarkut Dibër, si partner.

Pra, siç e shikoni, qarku i Dibrës në dy thirrje ka përfituar 4 projekte dhe mbetemi në pritje të projekteve të thirrjes së tretë, për të cilën po paraqitet kjo marrëveshje për ratifikim.

Në lidhje me performancën për përthithjen ky program ka një specifikë, sepse monitorimi financiar bëhet nga delegacioni i BE-së, i cili është subjekti kryesor kontraktues dhe financues. Pra, këto marrëveshje ndërmjet partnerëve shqiptarë dhe të Maqedonisë së Veriut lidhen me delegacionin e BE-së në Shkup, i cili ka kompetencën për të bërë edhe monitorime financiare.

Ky monitorim financiar, në bazë të rregullave të Komisionit European bëhet në vitin 2023, pra 3 vjet pas mbarimit të programit, ndërkohë, ne si institucion, për t’u rikthyer te roli i Ministrisë së Jashtme, kemi për detyrë të sensibilizojmë të gjitha subjektet potenciale përfituese të këtyre projekteve. Organizojmë ditë të hapura, jo vetëm online, por edhe në terren, ne dërgojmë ekipet tona, i trajnojmë, i informojmë në lidhje me bazën ligjore se çfarë duhet të kenë parasysh, jo vetëm në bazën ligjore të Komisionit European për legjislacionin shqiptar dhe atij të Maqedonisë së Veriut. Bëhet një koordinim i institucioneve, si këndej kufirit, ashtu edhe andej kufirit, pikërisht që subjektet përfituese të jenë sa më tepër.

Siç e shikoni edhe vetë, në thirrjen e tretë, fondet e vëna në dispozicion janë dyfishi i secilës prej thirrjeve të kaluara.

Në lidhje me informacionin për nënprojektet, ne mund të japim informacion sa ç’ kemi monitoruar ne nga pikëpamja e zbatueshmërisë.

Në lidhe me përfituesit shqiptarë, besoj se edhe në relacion del e qartë që në 9 projektet e para janë 13 partnerë shqiptarë, të cilët janë përfitues, nga të cilët 3 janë *lead-partner*, sepse në këtë lloj projektësh përcaktohet se cili është *lead* dhe cili është mbështetës.

Në thirrjen e dytë, nga 5 projekte janë 9 subjekte përfituese, nga të cilët njëri është *lead* shqiptar.

Duhet të kemi parasysh se në cilin shtet është zyra kontraktuese e delegacionit, pra, në qoftë se do të ishte në Shqipëri, në një marrëveshje të ngjashme IPA, normal që ne do të kishim më tepër avancë, por duke qenë se është në Shkup, sigurisht që ka një farë prioriteti praktik të subjekteve *lead*.

Në lidhje me sqarimin se sa është përfitimi potencial i Shqipërisë, aty është vënë një vlerë e përafërt prej 900 mijë eurosh, sepse shuma totale është 1 milionë e 800 mijë euro, që përfshin edhe pjesën e 15-përqindëshit që kontribuojnë subjektet përfituese dhe praktikisht ne do të përpiqemi të arrijmë te shifra 900 mijë euro, duke e ndarë shumën e përfitimit barabar ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Skapi!

Ju lutem, informacionin me shkrim që kërkuan kolegët, mbajeni shënim për ta sjellë, sidomos për zonën e Dibrës!

Ju do të jepni një informacion për të gjitha projektet për të gjithë zonat, por meqenëse u kërkua në veçanti nga zonja Çupi për një zonë, unë përmenda Dibrën.

Urdhëroni!

**Fatmir Mediu** – Ndërkohë që ne i miratojmë këto projekte, është e nevojshme që, përveç projektit, t'i përcillen parlamentit impakte përkatëse që këto kanë në realitet, sepse po jua them, të paktën, nga përvoja, janë shuma milionëshe që shkojnë në projekte të vogla dhe impaktin e kanë pothuajse minimal ose zero. Përgjegjësia jonë nuk është vetëm ta provojmë apo të kërkojmë projektin, por të shikojmë se çfarë ka në realitet. Është, padyshim, detyrë e qeverisë, por edhe ne, nga pikëpamja kushtetuese kemi të drejtë të informohemi.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Mediu, për ndërhyrjen shumë të vlefshme!

Unë sugjeroj që relatori i projektligjit, në raportin përkatës, që do t'i përcillet komisionit përgjegjës dhe seancës plenare për ta bërë këtë sugjerim të zotit Mediu. Besoj se të gjithë kolegët biem dakord.

Atëherë, kolegë të nderuar, e hedhim në votim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjet së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Europiane, dhe Komisionit Europian “Për programin e veprimit bashkëpunimi ndërkufitar IPA 2, Maqedonia e Veriut–Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2020”. Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Të gjithë dakord.

Miratohet.

Vazhdojmë me miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit? Kundër? Nuk ka. Abstenim?  
Nuk ka. Të gjithë dakord.

Miratohet.

Ky projektligj miratohet dhe i kalon seancës plenare dhe komisionit përgjegjës së bashku me raportin përkatës. Ngarkohet relatori dhe shërbimet e komisionit të përgatisin raportin me sugjerimet që dhamë.

Zoti Skapi, shumë faleminderit për prezencën tuaj! Jeni të lirë. Mos harroni informacionet me shkrim që ju kërkua.

**Sekretar**

**Klevis Xhoxhi**

**Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve**

**Euzheni Pengili**

**Sekretare e komisionit**

**Vijola Sinaj**



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.10.2021, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për ratifikimin e konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat”.

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Fatmir Xhafaj, Ermonela Valikaj (Felaj), Saimir Hasalla, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Arben Pëllumbi, Bardhyl Kollçaku, Lavdërim Krrashi, Oerd Bylykbashi, Gazment Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Dhurata Tyli (Çupi), Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Elda Hoti, Jurgis Çyrbja dhe Erisa Xhixho.

#### **Mungojnë:**

Bledjon Nallbati, Damian Gjikhuri, Gerta Duraku, Toni Gogu dhe Gledis Çeliku.

#### **Të ftuar:**

Vasilika Vjero – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Doriana Toro – Përgjegjëse e Sektorit të Tatimeve Direkte në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal pranë MFE-së

**Klotilda Bushka** –Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, kolegë: projektligjin “Për ratifikimin e konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat”. Ne jemi komision për dhënie mendimi.

Relator është kolegu Klevis Xhoxhi. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, për sa kohë është nismë e qeverisë dhe në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave: zonja Vasilika Vjetro, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, si dhe zonja Dorian Toro, përgjegjëse e Sektorit të Tatimeve Direkte në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal në këtë ministri.

Mirë se erdhët, zonja Vjetro, në komision!

Fjala është për ju për një prezantim të projektligjit.

**Vasilika Vjetro** – Faleminderit, zonja kryetare!

Përshëndetje, të nderuar deputetë!

Po bëj një prezantim të shkurtër të projektligjit. Konventa ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat krijon një bazë më të plotë tashmë për të gjithë trajtimin tatimor të atyre individëve, personave juridikë shqiptarë apo edhe Izraelit, të cilët kanë një aktivitet biznesi apo të ardhura të tjera, pra sigurohen nga aktiviteti i tyre, garantojnë të ardhura të tjera që bien nën juridiksionin tatimor të dy shteteve.

Duke pasur aktivitet në dy shtete apo duke qenë rezidentë i njërit nga shtetet që siguron të ardhura, individi apo edhe personi juridik shpeshherë mund të rëndohet me një tatim të dyfishtë, pra të tatóhet 2 herë për të njëjtën të ardhur, qoftë nga aktiviteti i tij i biznesit apo edhe aktivitete të tjera në të dyja vendet. Ne e dimë shumë mirë se është e njohur tashmë dhe botërisht që të tilla situata shpeshherë krijojnë edhe hapësira për evazion fiskal. Kjo konventë, dispozitat e së cilës kanë përparësi ndaj legjislacioneve tatimore të dy vendeve, trajton pikërisht faktin sesi mund ta shmangim këtë tatim të dyfishtë, duke e ndarë këtë të drejtë midis dy shteteve, por pa e rënduar subjektin për t’u tatuar 2 herë në të dyja vendet.

Konventa për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal ka një rol shumë të rëndësishëm, sepse ato ndihmojnë edhe në zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe midis vendeve, të cilat bien dakord për t’i nënshkruar këto konventa. Rëndësia e konventave sigurisht që po rritet gjithnjë e më shumë, është edhe një kërkesë e vazhdueshme e OECD-së për lidhjen e marrëveshjeve për taksimin e dyfishtë midis vendeve. Shqipëria ka rreth 42 marrëveshje të lidhura, ku vetëm vitet e fundit janë lidhur 8 marrëveshje. Pa diskutim që këto

marrëveshje ndihmojnë jo vetëm shmangien e evazionit, por dhe lehtësimin e të bërit biznes midis të dyja vendeve, pasi janë incentiva që paraprijnë zhvillime të aktivitetit ekonomik të kompanive apo edhe të individëve, të cilët janë pjesë e vendeve midis të cilëve lidhen këto konventa.

Kjo ishte një përmbledhje shumë e shkurtër, por për çdolloj pyetje jemi të gatshëm t'u përgjigjemi.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Zoti Xhoxhi, në cilësinë e relatorit, do të donim një përmbledhje të shkurtër. Ju kujtoj edhe një herë se jemi komision për dhënie mendimi, pra shohim përputhshmërinë e aktit me Kushtetutën dhe harmonizimin e tij me legjislacionin.

**Klevis Xhoxhi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 73 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës.

Në përfundim, në aspektin ligjor vlerësojmë se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Si relator, ftoj komisionin ta miratojë këtë konventë.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Kolegë, keni komente, pyetje? Nuk keni.

Atëherë, hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat”. Kush është dakord? Të gjithë dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Të gjithë dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zonja Vjero, për prezencën!

Punë të mbarë! Jeni e lirë të shkoni.

Kolegë, ky projektligj miratohet. Këshilltarët dhe relatori të përgatisin raportin për seancën plenare dhe për komisionin përgjegjës.

**Sekretar**

**Klevis Xhoxhi**

**Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve**

**Euzheni Pengili**

**Sekretare e komisionit**

**Vijola Sinaj**



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.10. 2021, ora 11:45

**Drejton mbledhjen:**

**Klotilda Bushka - kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Bashkëprodhimin Kinematografik (e rishikuar), Rotterdam, 30.01.2017”.

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Fatmir Xhafaj, Ermonela Valikaj (Felaj), Saimir Hasalla, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Arben Pëllumbi, Bardhyl Kollçaku, Lavdërim Krrashi, Oerd Bylykbashi, Gazment Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Dhurata Tyli (Çupi), Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Elda Hoti, Jurgis Çyrbja dhe Erisa Xhixho.

#### **Mungojnë:**

Bledjon Nallbati, Damian Gjijnuri, Gerta Duraku, Toni Gogu dhe Gledis Çeliku.

#### **Të ftuar:**

Entela Çipa – Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës.

Eduart Makri – Drejtor i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë



**Klotilda Bushka** – Viojmë me pikën e fundit të rendit të ditës: projektligji “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Bashkëprodhimin Kinematografik (e rishikuar), Rotterdam, 30.01.2017”. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Relatore do të jetë zonja Ermonela Felaj.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Kulturës, si përfaqësuese e Këshillit të Ministrave, zonja Entela Çipa, sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës, si dhe zoti Eduart Makri, drejtor i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.

Zonja Çipa, zoti Makri, mirë se erdhët në komision!

Një vërejtje para se të fillojmë, sipas rregullores së këtij komisioni, të rregullave që kemi vendosur, prandaj, ju lutem, kur të vini herën tjetër në komision përfaqësimi i ministrisë suaj duhet të bëhet edhe në nivel politik, jo vetëm në nivel administrativ dhe teknik. Këtë herë do ta vijojmë mbledhjen, por në mbledhjet e tjera, ju lutem, kijeni në konsideratë këtë çështje!

Faleminderit!

Zonja Çipa, fjala është për ju, për të na bërë një prezantim të projektligjit.

**Entela Çipa** – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Sot prezantojmë projektligjin “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës për bashkëprodhimin kinematografik (e rishikuar) Rotterdam, 30.01.2017”. Kjo konventë u miratua nga Këshilli i Ministrave në vitin 2019 me vendimin nr. 676 dhe është nënshkruar nga përfaqësuesja jonë në misionin e përhershëm të Këshillit të Europës.

Çfarë sjell kjo konventë? Disa vende të Këshillit të Europës kishin përqindje shumë të lartë për t’u konsideruar si bashkëprodhues kinematografik, por me anë të kësaj konvente është bërë e mundur ulja e kësaj përqindjeje, pra edhe prodhuesit e vendeve të vogla të quhen bashkëprodhues. Kjo bën të mundur që edhe prodhuesit e minorancës të kenë mundësi të përfitojnë nga fondet e Këshillit të Europës në prodhimin e filmave. Konkretisht, për bashkëpunimet dypalëshe përqindja e producentëve minoritarë ishte 20% dhe është ulur në 10%, ndërsa për bashkëprodhimet me më shumë se dy palë përqindja ka qenë në 10% dhe është ulur në 5%. Çfarë do të thotë kjo konkretisht? Kjo bën të mundur që kineastët shqiptarë jo vetëm të marrin pjesë në bashkëprodhimet kinematografike europiane dhe të përfitojnë nga fondet e tyre, por ata do të kenë të drejta në produksion, pra në vendimmarrje teknike dhe artistike, pra nuk do të jenë thjesht pjesëmarrës. Kjo konventë i garanton ata që të jenë me të drejta të plota në bashkëprodhim. Gjithashtu, një nga cilësitë e reja është se konventa i detyron të gjithë bashkëprodhuesit, edhe ata në minoritet, të kenë të drejta të njëjta financiare dhe juridike, pra mbrohen nga mosmarrëveshjet.

Një element tjetër që është shtuar është edhe vendosja e titrave, pra të gjithë bashkëproducentët që konsiderohen si të tillë në një film e kanë të detyrueshme vendosjen e titrave në të gjitha gjuhët e bashkëprodhuesve. Këto janë ato çfarë parashikohen në këtë konvente. Të gjitha shtetet anëtare janë në procedurë për ratifikimin e saj.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Çipa!

Fjalën e ka zonja Felaj, në cilësinë e relatores.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Çipa shprehu saktësisht përmbajtjen e projektligjit me të cilën ratifikohet konventa e rishikuar e Këshillit të Europës për bashkëpunimin kinematografik.

Më vjen mirë që Ministria e Kulturës është treguar e vëmendshme për ta parë këtë rishikim që ka ndodhur në konventë dhe menjëherë ka bërë të gjitha përpjekjet për ta miratuar. Kjo konventë u shërben shtëpive të produksionit shqiptar, të cilat, edhe pse mund të jenë modeste në bashkëpjesëmarrjen buxhetore, realisht kanë të drejta si të gjithë bashkëprodhuesit e tjerë, pra ata mbrohen dhe promovohen siç duhet. Pra rishikimi i konventës ua jep këtë mundësi shtëpive të vogla të produksionit.

Miratimi i këtij projektligji do t'i nxisë shtëpitë e produksionit që të marrin pjesë në bashkëpunimet e filmave dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Nga ana tjetër, shtëpitë e produksionit shqiptar, si edhe ato të huaja, pas miratimit të këtij projektligji, do të jenë njësoj të respektuara për sa u takon kriterëve që ka vendosur euroimazhi, që është një fond i Bashkimit Europian dhe që lidhet me filmin, i cili është krijuar që në vitin 1988. Pra, është e rëndësishme që të kuptojmë se ky projektligj i shërben në vetvete bashkëpunimit kulturor, një bashkëpunim i cili nuk mund të kuptohet nëse nuk ndodh në fushën e kinemasë, që në këtë rast realisht ndodh. Pra, ne u japin mundësi të gjithë shtëpive të produksionit që të rrisin veprimtarinë e tyre duke i siguruar që janë të mbrojtur edhe në anën e ideve, edhe në anën teknike.

**Klotilda Bushka** – Kush ka pyetje apo diskutime nga kolegët?

Po, zoti Alibeaj.

**Enkelejd Alibeaj** – Unë nuk kam diskutim, por e mira është që ne këtu të mos bëjmë filma, por t'i bëjnë ata.

Zonjë, keni sjellë ndryshimin e një marrëveshje, apo jo? Pyetja që kam është...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ja ta mbaroj unë. Pra, keni sjellë ndryshimin e një marrëveshje. Versioni i parë nuk funksiononte, prandaj keni ardhur me ndryshim. Cili është motivi i ndryshimit në terma të

numrit të bashkëproduksionit të tyre? Pra, sa shtëpi produksioni të vogla modeste shqiptare kanë pasur mundësi të bashkëpunojnë sipas versionit të parë?

E dyta, çfarë parashikoni ju, sepse ky është motivi i ndryshimit, për të ardhmen e këtyre shtëpive të produksionit shqiptar?

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Po, zoti Makri. Pastaj zonja Felaj.

**Eduart Makri** – Faleminderit, zonja kryetare!

Dua t'ju falënderoj të gjithëve dhe shpreh kënaqësinë time që jam këtu për të biseduar me ju për herë të parë!

Dua të bëj një saktësim, ndryshimi i këtij projektligji nuk vjen nga ne, por nga Europa, ne thjesht e ratifikojmë. Ky ndryshim ka ardhur për një arsye të vetme, sepse ka një racizëm financiar nga vendet që kanë fonde të mëdha në buxhetet kinematografike, prandaj është bërë presion ndaj tyre. Në çfarë kuptimi? Shpeshherë vendet e vogla, meqenëse kanë buxhete të pakta financiare, janë parë thjesht si një element financiar dhe nuk janë respektuar subjektet që vijnë nga vendet e vogla të Ballkanit Perëndimor, sepse ai që vendos më shumë lekë mendon se ka të drejtën e vetos për trajtimin e subjektit, për grupin e filmit, për punësimin në industri e të tjera. Duke bërë njëloj reagimi nga ana jonë, jo vetëm nga ana e Shqipërisë, por edhe nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, u pa e mundshme, e dobishme dhe e domosdoshme nga Këshilli i Europës për ta ndryshuar këtë dhe për ta ratifikuar. Ne jemi vendi i fundit që po e ratifikojmë, pra është ratifikuar nga të gjithë.

Pyetja juaj është me interes, por kjo ndodh meqenëse vendet e vogla, si Shqipëria, kanë buxhete të paketa, shpeshherë edhe maxhoriti ynë, që quhet kur ti ke një pjesë më të madhe të një projekti kinematografik, nuk është aq sa *minority* i atyre. Pra, në këtë sens, duke u ulur përqindjet me të cilat një grup shqiptar, malazez apo i një vendi të vogël si Bosnje Hercegovina, futet në prodhim, atëherë hiqet një pengesë financiare, që të hyjnë në prodhim me më pak lekë. Kjo është e para.

Nga ana tjetër, janë bërë barazime të vlerave dhe të të gjitha të drejtave që ka një vend me një buxhet fare të vogël në krahasim me një vend që ka një buxhet të madh, pra gëzohen të njëjtat të drejta. Këtu është favor i në të gjitha pikëpamjet dhe, si të thuash, dy elementet kryesore që ne përfitojmë. Prandaj e ratifikojmë këtë marrëveshje dhe kërkojmë të aplikohet, sepse sjell një interes shumë të madh.

**Enkelejd Alibeaj** – I kam parasysh se cilat janë ndryshimet dhe kuptohet thjesht: keni ulur pengesat me shpresën për të pasur më shumë akses, por para se të shkojmë te shpresa, të shohim të shkuarën.

Pyetja ishte e thjeshtë: sa shtëpi produksioni kanë mundur të çajjnë me versionin e parë, me të gjitha vështirësitë, siç thoni ju?

E dyta, besoj se këtu duhet të keni bërë një parashikim, sa mendoni ju që shtëpive të vogla modeste shqiptare të produksionit të filmit mund t'u rritet në terma konkretë ky akses?

E treta, që ta mbyll, shumë mirë që ministria juaj do të bëjë filma me produksion shqiptar, po për kinematë a ka menduar gjë?

Faleminderit!

**Eduart Makri** – Duke u kthyer tek tri pyetjet e para, edhe në të kaluarën ne kemi bërë bashkëprodhime dhe, të paktën në këta 2 vjet që jam unë këtu, të gjitha bashkëprodhimet kinematografike kanë qenë me dy ose me shumë partnerë. Një nga partnerët kryesorë ka qenë Kosova, sepse, si të thuash, kemi pasur një afërsi dhe në të gjitha filmat ku Kosova ka marrë çmime kanë qenë financuese edhe qendrat kombëtare të kinematografisë, pra janë financiar nga dy ose më shumë partnerë. Ne kemi pasur vazhdimisht marrëdhënie bashkëprodhimi me Greqinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, më pak me Bosnje Hercegovinën dhe më pak se të tjerët. Tani, këto do të rrisin... Me çfarë mundësie do të rrisim ne? Tani po shkohet nga bashkëprodhime në dy vetë, në formula financiare më të mëdha, sepse rreziku është më i vogël. Kështu që shtëpitë e vogla prodhuese do të kenë mundësi të futen në bashkëprodhime më shumë se dypalëshe.

**Enkeljed Alibeaj** – Shpresoj...

**Eduart Makri** – Do të ndodhë.

**Enkeljed Alibeaj** – Pyetja është: sa? Në terma.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Eduart Makri** – Nuk kanë qenë aq. Konventa e vjetër ka funksionuar dhe të gjitha bashkëprodhimet që kemi bërë ne, në këta 2 vjet janë bërë 70 e ca, kanë qenë dypalëshe ose tripalëshe.

**Enkeljed Alibeaj** – Ku pretendojmë të shkojmë?

**Eduart Makri** – Pretendojmë të shkojmë më shumë, normalisht.

**Enkeljed Alibeaj** – Sa?

**Eduart Makri** – Nuk mund ta them dot që tani, se po ta thosha do të gënjeja.

Do të jetë më e lartë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Klotilda Bushka** – Zoti Alibeaj, sqaroheni edhe një herë atë që kërkoni të dini.

**Enkeljed Alibeaj** – Fakti që është lënë si pikë e katërt e rendit të ditës nuk do të thotë që ky parlament nuk ka sensibilitet për këtë çështje, madje ka shumë, sidomos në periudha të

tilla, ju e thatë, tashmë jemi të dyja palët, për të mos bërë filma, por duhet një arsyetim qoftë dhe minimalist se ku do të shkoni me këtë ratifikim, se është marrëveshje, ka fonde të Euroimage-it. Nuk keni bërë një përlllogaritje sa do të jetë rritja teorikisht, sipas një analize, apo thjesht ka ardhur marrëveshja dhe “hajde se e konsiderojmë punë”? Rëndon ndodh edhe kjo gjë, apo jo? Prapë qëndron pyetja, çfarë projekti, çfarë politike ka ministria për kinematë? Bëjmë filma, por nuk kemi ku t’i shohim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Klotilda Bushka**- Zoti Makri, mund të jepni një përgjigje.

I kujtoj kolegët që jemi duke miratuar tekstin e ndryshuar të një konvente të Këshillit të Europës, tek e cila nuk kemi qenë anëtare, por po bëhemi sot, në këtë proces ku jemi, dhe të dhënat që kërkohen duhet të jenë rreth kësaj çështjeje, sepse më parë nuk kemi pasur një praktikë mbi një bazë ligjore si kjo për të cilën po diskutojmë, në mënyrë që të kemi disa statistika se ku duhet të shkojmë në të ardhmen. Bëhet fjalë për draftin e një konvente.

Zoti Makri, mund t’i jepni përgjigje zotit Alibeaj.

Më pas do të flasë zonja Felaj.

**Eduart Makri** – E para, do të përgjigjem si kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, jo si ministri.

E dyta, është e sigurt se numri i bashkëprodhimeve do të jetë më i madh, sepse ky është qëllimi i ratifikimit të saj, që detyrimisht do ta nxisë, për të qenë diku te 70 e ca.

Në kuadër të kinemave, që është çështje sensitive edhe për ne, kemi një projekt për ngritjen e sistemit të distribucionit të filmit në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, i cili ka dhënë dy rezultatet e para. Kur ti bën një film, ngjason me tregtinë e domateve, nëse nuk ke treg për ta shitur, nuk ka sens.

Ne kemi inauguruar dy kinema të një niveli shumë të lartë, të Vlorës dhe të Gjirokastrës. Ato kanë ekrane *HD portable*, të lëvizshme, që shërbejnë jo vetëm për të ngritur një kinema në mënyrë statike dhe të ngurtë, por, për shembull, nëse vendoset të bëhet Festivali Kombëtar në Kalanë e Gjirokastrës, që është objekt turistik dhe arkeologjik i të gjitha gjërave. Kjo kinema lëvizet, vihet aty, bëhet Festivali i Filmit me kualitet absolut të të njëjtit nivel ndërkombëtar dhe çohet sërish në dimër atje ku ishte.

E njëjta gjë edhe për kinemanë e Vlorës, e cila ka të njëjtin standard.

Pra, dy kinema kanë filluar tashmë dhe është një projekt që, mundësisht, brenda 2-vjeçarit të mandatit tim, t’i vë në vijë për t’i bërë.

Kinematë në rrethe kanë disa probleme të tjera, si pronësi, dhe ne kemi bërë studime të sakta për të gjitha, se ku janë, në çfarë gjendje janë. Procesi ka filluar, vazhdon dhe besoj se do të ecë mirë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Felaj.

Më pas do të kalojmë në votim.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju lutem, kolegë!

Ia kam dhënë fjalën zonjës Felaj.

Më lejoni mua si kryetare të vendos.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Korreshi, nuk thashë se do t’jua jepja fjalën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Bardhi, ju lutem!

A mund të mbani qetësi, sepse ia kam dhënë fjalën zonjës Felaj?

Më pas mund të kërkonte fjalën.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë nuk kam çfarë të shtoj për projektligjin në vetvete, sepse përgjigjet u dhanë sot nga përfaqësuesit e propozuesve të projektligjit, edhe përtej tagrave që i takojnë këtij komisioni. E vë theksin këtu, sepse duhet të bëjmë dallimin që, kur jemi në komision për dhënie mendimi, duhet t’i përmbahemi tagrave tona.

A është projektligji në përputhje me Kushtetutën, apo jo? Kjo është përgjigjja kryesore që duhet të japë ky komision, që ta lejojë këtë projekt, nga ky komision të shkojë në komisionin përgjegjës...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, a të mbaroj!

Unë besoj se është në nderin tonë, dhe këtu nuk do të bëja asnjë diferencë partiake, që ne t’i hapim rrugë këtij projektligji nëpërmjet votimit. Kështu mund të nderojmë edhe kineastët tanë, të cilët në jo pak raste kanë marrë çmime ndërkombëtare, dhe duhen vlerësuar që ndër vite kanë punuar në kushte dhe në terren të vështirë. Nuk është çdo gjë rozë dhe ne e dimë këtë, por ky projekt ndihmon në vetvete ata. Nuk kemi pse të ndahemi dhe të tregojmë mungesë respekti ndaj këtyre kineastëve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sjellja jonë dyshoi se shkoi deri në këtë pikë dhe nuk është në nderin tonë.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Felaj!

Zoti Korreshi, doje fjalën për rendin e ditës?

**Saimir Korreshi** – Kryetare, ideja është se vijmë deri në këtë moment dhe ne nuk kemi të drejtë të bëjmë pyetje, qoftë edhe brenda llojit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull, por do të duket sikur ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Meqenëse kishit inventarizuar të gjitha kinematë, ju thatë se jeni të gjithë në dijeni, por a e dini se shumë qytete janë pa kinema? Realisht, ne kemi 30 vjet pa kinema ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord.

Juve ndoshta nuk ju duket interesante, por ka ardhur ...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Besoj se ne kemi të drejtë të bëjmë kaq ...

Më falni!

*(Diskutime pa mikrofon)*

...sepse të gjithë kanë të drejtë, siç the ti, Gjirokastrë, Vlorë, e të vijë edhe në Lushnjë. Meqë s'kemi kinema fikse, duke qenë se të tjerat kanë, a mund të vijë ndonjë nga këto portablet në Lushnjë?

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Më falni, por nuk do të përgjigjeni zoti Makri!

Dua të bëj një gjë të qartë për të gjithë anëtarët e komisionit. Shumica e dinë, të gjithë e dinë, në fakt, ndaj ju lutem: pyetjet duhet të jenë rreth projektaktit. Sigurisht, edhe pyetjet që ju bëni kanë rëndësinë e vet, sepse ju flisni për zonat prej nga vini, por zoti Makri apo përfaqësuesja e ministrisë nuk mund të jenë këtu për të gjitha çështjet që na vijnë neve në mendje.

Meqenëse keni pyetje specifike, ju këshilloj të ushtroni mekanizmat që ju jep Rregullorja dhe ligji “Për statusin e deputetit”. Bëni kërkesa për informacion, bëni kërkesa me shkrim. Ose mund ta bëni këtu: që kërkonti një informacion në lidhje me këtë çështje, e kësisoj t'u kërkojmë përfaqësuesve që vijnë për këtë projektakt sot, t'ju sjellin një përgjigje për pyetjet që keni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sepse nuk është e mundur që zoti Makri, drejtor i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, të dijë gjithë politikën e Ministrisë së Kulturës për kinematë dhe kinematografinë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ai u përgjigj për aq gjëra sa di. Nga ana tjetër, edhe ju duhet të dini...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Bardhi, mos më ndërprisni, se po flas, ju lutem!

Edhe ju e dini shumë mirë, që për çështjet e rendit të ditës do të diskutojmë në çdo moment, sa të duam dhe sa herë të duam, por nuk mund ta kalojmë diskutimin në çdo çështje që ngjason pak edhe në ngjyrë me rendin e ditës. Të drejtat që kemi na japin edhe detyrimin t'i respektojmë të drejtat proceduriale në një komision. Edhe abuzimi me të drejtat tona proceduriale është shkelje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Tani, unë nuk dua të kaloj në këtë diskutim, sepse jemi edhe në fund të mbledhjes, por ju lutem, me seriozitet e me përgjegjshmëri, për sa na takon.

Zoti Makri, nuk jeni i detyruar t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje.

Nëse zonja Çipa ka një përgjigje, mund ta japë, për ta mbyllur diskutimin, e më pas do të kalojmë në votim.

**Eduart Makri** – Jo, unë do të përgjigjem një sekondë, sepse...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Faleminderit!

Në këtë rast, unë do të dal pak nga kuadri i skemës këtu. Unë vetë jam regjisor, skenarist dhe aktor, ndaj do t'ju lutesha që mua, si kryetar i qendrës, të më konsideroni si specialist të kinematografisë dhe jo si një objekt për kundërshtitë që keni ju me njëri-tjetrin, e këtë ia them edhe maxhorancës, edhe opozitës, sepse filmi është i të gjithëve dhe artistët janë të të gjithëve. Është i vetmi vend, ku ndoshta ne nuk atakohemi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër! Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më falni një minutë! A mund të vazhdoj?

Ky nuk është inventarizim. Më tepër është një diagnostikim i gjendjes së kinemave dhe ka filluar si proces. Pra, ne e kemi parë me ndjeshmëri. Unë vetë jam regjisor, dhe në qoftë se pas dy vjetësh do të bëj filma, ku do të shfaqen filmat e mi?



Prandaj, jam shumë i ndjeshëm ndaj këtij problemi. Ne do të bëjmë presion ndaj qeverisë, që të rriten fondet për investimet e kinemave. Kemi një projektvendim të gatshëm. Do ta diskutojmë dhe do ta bëjmë në të ardhmen.

Kësisoj, mendoj se jeni të mbështetshëm, sepse rezultatet do të jenë të shpejta.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Makri!

Në fakt, ne kemi shumë respekt për të gjithë artistët e regjisorët, dhe besoj se asnjëri prej nesh nuk e përziën çështjen e politikës me çështjen e artistëve. Kësisoj, për sa më takon si kryetare, por mendoj se kam edhe mbështetjen e kolegëve, për çdo lloj çështjeje që mendoni se ne mund t'ju mbështesim, jemi të hapur. Besoj se të gjithë kolegët janë dakord me mua. Respekt për të gjithë profesionistët e artit dhe kinematografisë.

Tani do të kalojmë te votimi i projektligjit “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës për bashkëprodhimin Kinematografik, Roterdam, 30.01.2017”.

Kush është dakord në parim?

Të gjithë dakord.

Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Dakord!

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1 të projektligjit?

Dakord!

Kush është dakord me nenin 2?

Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Dakord!

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin?

Të gjithë dakord!

Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet edhe ky projektligj!

Këshilltarët e komisionit dhe relatorja të përgatisin raportin për seancën plenare dhe për komisionin përgjegjës.

Ju falënderoj, zoti Makri!

Faleminderit, zonja Çipa!

Kolegë, në lidhje me mbledhjen e radhës do të njoftoheni!

Shumë faleminderit!

**MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretar**

**Klevis Xhoxhi**

**Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve**

**Euzheni Pengili**

**Sekretare e komisionit**

**Vijola Sinaj**